



KOMUNA E MALISHEVËS

BULETINI



Nr. 98-Gusht 2011 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga asfaltimi i dy rrugëve në dy lagje të Pagarushës dhe renovimi i kullës në Llapceve



Përmbajtja

Mbahet dëgjimi publik për draft-buxhetin 2012	2
Malisheva ofron përkrahje qytetarëve të Mitrovicës	3
Zyrtarë nga niveli qendror vlerësojnë punën komunale të Strategjisë për riintegrim	4
Sot fillon intervistimi për pranimin e kuadrit mësimor	5
Në Malishevë s'ka produkte serbe.....	6
Kryetari Kilaj, vizitoi Shpellën e Mermertë në Temeqinë	6
Rinovohet kulla në Llapqevë	7
Shtrohen dy rrugë në Pagarushë	8
Përfundon muaji i mërgimtarëve në Malishevë	8
Në kuadrin arsimor të përzgjidhen më të mirët	9
Rregullohet shtrati i lumit Mirusha.....	10
Shtohen masat për lokalizimin e zjarreve	11
Funksionojnë 6 QMF dhe 7 ambulanca shëndetësore	11
Miratohet buxheti komunal për vitet 2012-2014.....	12

Mbahet dëgjimi publik për draft-buxhetin 2012

Malishevë, 2 gusht



Drejtoria komunale për Buxhet e Financa, ka mbajtur sot dëgjimin publik me qytetarët, në lidhje me draft-buxhetin për vitin 2012.

Sipas drejtorit të kësaj drejtorie, z. Vesel Krasniqi, “buxheti i paraparë për vitin 2012 për komunën e Malishevës, do të jetë 9 milion e 871 mijë euro”. Po sipas z. Krasniqi, komuna ka planifikuar që për investime kapitale të ndajë afër 2.8 milion euro.

Nga i gjithë totali i lartpërmendur, mjetet janë të ndara në kategori të ndryshme.

Sipas kufijve të rekomanduar në Qarkoren Nr-1-2 për Buxhetin 2012 nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Granti i Përgjithshëm është 9,013,193 euro, ndërsa Plani i të Hyrave Vetanake është 858,413 euro. Nga totali i projekt-buxhetit për vitin 2012, sa i përket ndarjeve janë si në vijim:

- Për Administratë 3,647,607 euro,
- Për Arsim, 5,194,534 euro;
- Për Shëndetësi 1,028,465 euro.

Në secilën shumë të secilës kategori, janë të përfshira grantet dhe të hyrat vetanake, ndërsa janë të ndara për: paga, mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere dhe për investime kapitale.

Malisheva ofron përkrahje qytetarëve të Mitrovicës

Malishevë, 3 gusht

Komuna e Malishevës, përkatësisht drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, Halit Zogaj, ka ofruar gjithë mbështetjen e mundshme për homologun e tij në Mitrovicë, Behxhet Bala, pas situatës së krijuar në veri të Kosovës. Kjo u ofrua të mërkurën gjatë një vizite të Zogajt në Komunën e Mitrovicës.

Fillimisht drejtori Bala e falënderoi përzemërsisht homologun nga Malisheva për interesimin dhe mbështetjen në këto ditë, kur gjendja në veri vazhdon të mbetet e paqëndrueshme. Ndërsa më pas e

njoftoi atë me situatën e fundit. Tha se gjendja është e qetë, por aspak e qëndrueshme. “Serbët e urdhëruar nga qeveritarët e Beogradit janë duke mbajtur ende të bllokuara rrugët magjistrale në veri, duke krijuar tensione në atë pjesë të vendit”.

Tha se më së rëndi gjendja është për banorët shqiptarë që jetojnë në tri fshatra të Leposaviqit, të cilët që disa ditë kanë mbetur të izoluar. “Ne jemi mobilizuar që me të gjitha kapacitetet t’u ndihmojmë banorëve që kanë nevojë për ushqime dhe gjëra tjera”

Theksoi se javën e kaluar kanë dërguar dy herë ndihma ushqimore dhe mjete higjienike për banorët e atyre fshatrave. “Kemi ndihmuar me artikuj ushqimorë dhe kemi nisur rregullimin e një rruge malore në mënyrë që ata të mos mbeten krejtësisht të izoluar”.

Ndërsa drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Malishevës, Halit Zogaj, tha se komuna dhe qytetarët malishevas bashkëndejnë me qytetarët e Mitrovicës. “Ne jemi në dispozicion tuaj për çfarëdo që mund t’u ndihmojnë në këtë situatë”.

Zyrtarë nga niveli qendror vlerësojnë punën komunale të Strategjisë për riintegrim

Malishevë, 9 gusht

Zyrtarë nga niveli qendror qeveritar, kanë vizituar sot komunën e Malishevës, me ç’rast janë takuar me nënkryetarin e komunës z. Rexhep Mazreku, dhe drejtorë të drejtorive komunale. Qëllimi i kësaj vizite ishte vlerësimi i punës komunale në lidhje me implementimin e Strategjisë për Riintegrim.



Merita Dalipi nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Kreshnike Shatri, nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Habib Habibi nga organizata IOM, janë interesuar për mbarëvajtjen e punës në lidhje me çështjen e të riintegruarve, në komunën e Malishevës.



Zyrtari për Integritet, z. Bashkim Krasniqi, ka njoftuar se deri më tani komuna e Malishevës, ka evidentuar nëntë familje, me përafërsisht 36 banorë, që janë kthyer nga shtete të ndryshme të botës. “Ata kanë kërkuar ndihmë administrative, dhe komuna i është përgjigjur në këtë drejtim. Edhe zyrtarja për kthim ka vizituar familjet në fjalë”. Kështu ka bërë të ditur Bashkim Krasniqi, zyrtar për integritet.

Në anën tjetër drejtori i Drejtorisë për Arsim, z. Isuf Morina, ka njoftuar poashtu se në këtë sektor nga vitit 2009, janë evidentuar 54 nxënës (të kthyer), të cilët janë integruar menjëherë në procesin mësimor.

Përfaqësuesit e nivelit qendror qeveritar, janë interesuar edhe për çështje të tjera, si dhe kanë këshilluar zyrtarët komunal, për procese të tjera në këtë drejtim, si njëri ndër kushtet e liberalizimit.

“Ju duhet pranuar çdo kërkesë nga çdo i kthyer, qoftë për çështje sociale, qoftë për atë të arsimit, shëndetësor, etj, dhe ato kërkesa më pas duhet drejtuar tek niveli qendror”, kështu tha midis tjerash Kreshnike Shatri nga MPB.

Një çështje tjetër e diskutuar ishte edhe ajo e statistikave të të kthyerve që evidentohen në Zyrën e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, e cila domosdo duhet ofruar edhe zyrrave komunale për kthim.

Me këtë rast ftohen të gjithë qytetarët e kthyer në Malishevë (nga bota perëndimore), që të lajmërohet në Zyrën komunale për Kthim ose në atë për Integritet, me ç’rast do të merren të gjitha informacionet e kërkuara si dhe do të bëhet riintegrimi i tyre në jetën dhe shoqërinë kosovare.

Sot fillon intervistimi për pranimin e kuadrit mësimor

Malishevë, 15 gusht

Duke filluar nga dita e sotme, Drejtoria për Arsim dhe Edukim e Komunës së Malishevës, fillon intervistimin e kandidatëve, për pranimin e kuadrit mësimor, për vitin shkollor 2011-2012, në të gjitha nivelet e arsimit.



Në lidhje me këtë interesimi për të punuar në arsim është mjaft i madh, ku për një vend pune, kanë aplikuar, 4.05 kandidat.

Sipas Remzi Buçajt, zyrtar në Drejtorinë Komunale për Arsim dhe Edukim, “ në të gjitha nivelet e arsimit, nga ai para fillor, e deri në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, janë hapur 152 vend të lira, me orë të plota dhe plotësuese, ndërsa kanë aplikuar 617 kandidat, ose 4.05 kandidat për një vend”.

Në këtë shifër nuk është i përfshirë numri i atyre që kanë aplikuar për konkursin e hapur për “Qendrën e Kompetencës”, i cili do të jetë i hapur edhe dy ditë të tjera.

“Gjatë procesit të intervistimit, do të zbatohen në përpikëri kushtet e parapara me konkurs, ndërsa në rast se asnjë kandidat nuk i plotëson kushtet, atëherë merret parasysh kualifikimi më i përafërt me kriteret e kërkuara”, tha Drejtori për Arsim dhe Edukim, Isuf Morina.

Në Malishevë s'ka produkte serbe

Malishevë, 15 gusht

Që nga hyrja në fuqi e vendimit për reciprocitet me Serbinë, në Malishevë nuk janë importuar produkte serbe.

Ismet kafexholli, drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit në Malishevë ka bërë të ditur se tashmë inspektorati ka kryer kontrollin dhe sipas faturave ka konstatuar se nuk ka hyrje të mallit të Serbisë në këtë komunë.

“Kontrollin e kemi kryer në bazë të një Urdhërese të organeve qendrore dhe nga ky kontroll ka dalë konstatimi se në Malishevë që nga shpallja e kësaj mase nuk kanë hyrë prodhime nga Serbia”, është shprehur Kafexholli.

Ndërkohë sipas drejtorit Kafexholli “ në rast të ndonjë pengese, atëherë duhet të njoftohen institucionet qendrore, por njëherë për njëherë, aksioni ka shkuar pa asnjë pengesë dhe nuk kemi pas nevojë për ndihmë në këtë drejtim”, ka përfunduar Kafexholli.

Kryetari Kilaj, vizitoi Shpellën e Mermertë në Temeqinë

Malishevë, 17 gusht



Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Ismi Kilaj, ka vizituar sot, shpellën e zbuluar në fshatin Temeqinë, për të parë nga afër këtë bukuri, por edhe për tu angazhuar në mbrojtjen e saj, si njërën prej pasurive të Malishevës.

Z. Kilaj, ka këshilluar për sigurimin e hyrjes së shpellës, deri në një afat kur të ndërmerren hapa nga organet kompetente, në mënyrë që të mbrohet nga dëmtimet eventuale, ndërsa shpellën e ka quajtur “pasuri e Malishevës dhe një vend i veçantë, i pasur me vlera dhe

bukuri nëntokësore, të rralla jo vetëm në Kosovë, por në tërë Evropën”.

Kjo shpellë, e pasur me stalaktite dhe stalagmite, kristale dhe me figura të krijuara të krijuara në forma të ndryshme, është zbuluar nga i riu Fatmir Zabelaj.

Në anën tjetër, drejtoria komunale për Kulturë, Rini dhe Sport, e ka njoftuar Institutin Arkeologjik të Kosovës, të cilët kanë premtuar formimin e një grupi punues, i cili do të merret me hulumtimin e saj, shënimin e saj si pikë turistike, ndërsa në të ardhmen priten edhe investime për hapjen dhe hulumtimin e mëtutjeshëm.

Shpella e Temeqinës, është njëra ndër shpellat e veçanta të zbuluara në territorin e Malishevës, duke ju bashkuar kështu vargut të shpellave, si ajo e Flladit në Panorc dhe Shpella e mermertë në Ngucat.

Rinovohet kulla në Llapqevë

Malishevë, 19 gusht

Ka filluar rinovimi i kullës në fshatin Llapqevë, e cila është njëra prej kullave më të vjetra shqiptare në territorin e komunës së Malishevës dhe njëra prej pasurive më të çmuara të trashëgimisë kulturore dhe historike në këtë komunë. Për të parë nga



afër punimet rreth rinovimit të kësaj kulle, Llapqevën sot e ka vizituar Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj.

Qëllimi i vizitës, ishte vëzhgimi i punimeve, por edhe mbështetja në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe traditave të kullave shqiptare. Kryetari Kilaj, e ka cilësuar, jo vetëm vlerë e trashëgimisë kulturore e historike, por edhe pjesë e rëndësishme e zhvillimit të turizmit në Malishevë.

Kulla në Llapqevë, është njëra prej dy kullave që do të rinovohen nga komuna. Kulla tjetër, e cila pritët të rinovohet, është ajo në Lagjen e Hazrollajve në fshatin Banjë, me një arkitekturë tradicionale shqiptare, e cila po ashtu e mbrojtur dhe pjesë e rëndësishme e së kaluarës sonë.

Shtrohen dy rrugë në Pagarushë

Malishevë, 19 gusht

Në fshatin Pagarushë, ka përfunduar asfaltimi i dy rrugëve, në lagjet e Dukoje dhe Lacaj, me çka u realizuan edhe dy projekte, në vazhden e listës së shumë projekteve kapitale, që komuna është duke i realizuar gjatë këtij viti, në infrastrukturën rrugore.



“Pagarusha meriton shumë më shumë, por këto janë mundësitë e kufizuara buxhetore. Mirëpo, gradualisht, infrastruktura e këtij fshati do të jetë e kompletuar, pasi tashmë kanalizimet e lagjeve janë në fazën përfundimtare, ndërsa rrugët do të vazhdojnë edhe në lagjet tjera në të ardhmen e afërt”, tha Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, gjatë vizitës që i bëri Pagarushës, me rastin e asfaltimit të këtyre dy rrugëve.

Ndërsa kryetari i fshatit, Sahit Krasniqi, u shpreh tejet i kënaqur me investimin e komunës, si në rrjetin e kanalizimit, ashtu edhe në asfaltimin e rrugëve, duke e konsideruar “si një ëndërr, të cilën në ish sistemin e kaluar, as që kanë mundur ta paramendojnë banorët e këtij fshati”.

Përfundon muaji i mërgimtarëve në Malishevë

Malishevë, 19 gusht

Kanë përfunduar aktivitetet e ndryshme kulturore dhe sportive me rastin e muajit të mërgimtarëve në komunën e Malishevës. Këto aktivitete janë përmbyllur në fundjavë, me një koncert në Shtëpinë e Kulturës “Tahir Sinani” dhe me një mbrëmje të madhe rinore, në parkun e qytetit.



“Ju falënderoi për pjesëmarrjen tuaj, në këtë koncert të organizuar për ju, në shenjë respekti dhe falënderimi për kontributin tuaj që keni dhënë me gjenerata e gjenerata, për këtë që ne sot gëzojmë. Kjo është liria e Kosovës, që falë gjakut të dëshmorëve dhe kontributit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kontributit të jashtëzakonshëm të bashkatdhetarëve tanë, ne jemi këtu ku jemi sot”, tha mes tjerash, kryetar i komunës, z. Isni Kilaj, në koncertin e mbajtur në Shtëpinë e Kulturës në Malishevë.

Aktivitetet e filluara me aktivitete sportive, janë përmbyllur me një mbrëmje rinore në Sheshin e Dëshmorëve në Malishevë, në Malishevë.

Nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve

Në kuadrin arsimor të përzgjidhen më të mirët

Malishevë, 22 gusht

Në mbledhjen e sotme të Bordit të Drejtorëve, e kryesuar nga kryetari z. Isni Kilaj, janë diskutuar një varg çështjesh.

Kryetari ka kërkuar nga drejtori i Arsimit, që të caktohet një datë, për përzgjedhjen e Palestrës së Sporteve në Carrallukë, e dhuruar nga KFOR-i gjerman, ndërsa e montuar dhe me shpenzimet tjera përcjellëse, nga komuna e Malishevës. Njëkohësisht është kërkuar, që në procesin edukativo arsimor, të mos pranohen kuadro me shkollim të mesëm. “Fillimisht le të sistemohen ata që janë të kualifikuar, mandej ata që janë në përfundim të studimeve, e assesi ata që janë vetëm me shkollim të mesëm”, tha kryetari Kilaj. Kjo sipas tij, bëhet me qëllim të ngritjes së cilësisë në arsim, “prandaj në këtë drejtim, kërkoj një përzgjedhje të kuadrit, pa asnjë anim, as politik as familjar”, ka shtuar më tej kryetari i Komunës së Malishevës.

Gjithashtu, kryetari njoftoj Bordin se ka marrë një letër mbështetëse nga Ministria e Pushtetit Lokal, që së bashku me komunën do të shtrojnë një rrugë në fshatin Rud. Njëkohësisht është kërkuar që të bëhet matja e rrugëve brenda fshatit Bubavec, ngase disa donator të këtij fshati, kanë shprehur interesimin për asfaltimin e tyre.

Drejtori i Drejtorisë së Financave në Malishevë, z. Vesel Krasniqi, bëri të ditur se si drejtori kanë përfunduar hartimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, për vitet 2012-2014, e cila pritët të dal në kuvend, në mbledhjen e radhës që do të mbahet me 29 gusht.

Edhe drejtori i Shërbimeve Publike, z. Alban Kastrati bëri të ditur, se këtë muaj, janë shtuar kërkesat e qytetarëve për furnizim me ujë të pijes, për ç'gjë deri tash janë shpërnda 50 cisterna.

Rregullohet shtrati i lumit Mirusha

Malishevë, 24 gusht

Kanë filluar punimet e fazës së parë, për hapjen dhe rregullimin e shtratit të lumit Mirusha, në qytetin e Malishevës, me qëllim të gjelbërimit përgjatë tij dhe evitimit të vërshimeve.

Ky projekt financohet nga Komuna e Malishevës dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).



Sipas drejtorit të drejtorisë komunale për urbanizëm, z. Esat Paçarizi, “kjo është faza e parë e këtij projekti, ku janë paraparë hapja, ndryshimi i rrjedhës së lumit dhe rregullimi i shtratit me gurë, përmes së cilës synohet gjelbërimi përreth lumit dhe evitimi i vërshimeve”.

“Rregullimi i shtratit, në fazën e parë do të bëhet me gurë, do të mbillen drunj dhe punime tjera, ndërsa në fazën e dytë, do rregullohen pjesët anësore, ku parashihen gjelbërimi, trotuari dhe rruga”, tregon drejtori Paçarizi.

Faza e parë e projektit është 630 metra gjatësi e rrjedhës së lumit dhe me një gjerësi prej dhjetë metrave, kurse shumica e projektit është rreth 190 mijë, ku donator për realizimin e këtij projekti janë Komuna e Malishevës me 90 mijë euro dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me 100 mijë euro.

Shtohen masat për lokalizimin e zjarreve

Malishevë, 26 gusht



Me qëllim të lokalizimit aktual dhe parandalimin e zjarreve të reja, komuna e Malishevës ka ndërmarrë masat me aktivizimin e vullnetarëve në ndihmë të zjarrfikësve, ndërsa për zjarrin më të madh që ka kapluar malet mbi fshatrat Pagarushë, Janqisht dhe Shkozë, është kërkuar edhe ndihma e KFOR-it.

Kryetari i komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka kërkuar nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, aktivizimin e vullnetarëve në ndihmë të zjarrfikësve dhe marrjen e të gjitha masave tjera, për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit në

malin Cer, që shtrihet mbi fshatrat Pagarushë, Janqisht dhe Shkozë, e ku gjendja është e rëndë, pasi zjarri ka përfshirë një territor të madh, i ardhur nga malet e Suharekës dhe Rahovecit.

Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Halit Zogaj, në dy takime me zyrtarë të KFOR-it zviceran dhe austriak, në vendin e ngjarjes, ka kërkuar ndihmë për intervenim nga ajri, pasi sipas tij “pozita e malit, ku aktualisht është zjarri, është tepër e vështirë për depërtimin e zjarrfikësve, ndërsa përhapja e zjarrit do të rrezikonte seriozisht jetën dhe pronat e fshatrave që janë shtrihen përgjatë malit”.

Përpjekjet e zjarrfikësve, tash e disa ditë me radhë janë shumë të mëdha, dhe kanë arritur që të shuajnë mbi pesë kilometra zjarr në këtë pjesë (teren që vetëm në këmbë kanë mundur të depërtojnë), por zjarri që aktualisht është përhapur mbi fshatin Janqisht, është në teren të pakalueshëm për zjarrfikësit, pasi nuk mund të depërtohet as në këmbë.

Në komunën e Malishevës

Funksionojnë 6 QMF dhe 7 ambulanca shëndetësore

Malishevë, 29 gusht



Në komunën e Malishevës, aktualisht veprojnë dhe janë në shërbim të qytetarëve gjashtë Qendra të Mjekësisë Familjare-QMF dhe shtatë ambulanca shëndetësore, përjashtuar nga kjo shifër Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare- QKMF në qytetin e Malishevës.

Sipas drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z. Skënder Hoti “gjendja reale sa i përket QMF-ve dhe ambulancave shëndetësore në komunën e Malishevës, është si në vijim:

- Në Kijevë funksionon QMF, me mjekun dhe stafin përcjellës çdo ditë pune;
- Në QMF në fshatin Bellanicë, poashtu;
- Në QMF në Pagarushë, mjeku punon katër ditë në javë, ndërsa stafi teknik pesë ditë pune;
- Në QMF në Tërpezë e Drenovc, poashtu,
- Në QMF në Panorc, mjeku dhe stafi i mjekësor, punojnë katër herë në javë, ndërsa stafi teknik, gjysmë orari në këtë QMF e gjysmë ne punktun shëndetësor në Llapqevë”.

Në këtë kontekst, drejtori Hoti bëri të ditur gjithashtu se përveç QMF-ve, në komunën e Malishevës, funksionojnë edhe shtatë ambulanca të tjera shëndetësore.

Sipas tij, në këto ambulanca punohet kështu: “në Llozicë, Fshat i Ri, Llapçevë, Carrallukë, Lubizhdë e Kravasari, mjeku i përgjithshëm punon nga dy ditë në javë, stafi teknik, punon çdo ditë punë, ndërsa në Dragobil, mjeku punon tre ditë në javë, e stafi teknik pesë ditë pune”.

Përveç këtyre të dhënave, z. Hoti ka sqaruar se orari i përhershëm në sektorin shëndetësor, është sikur u tha më lartë, ndërsa mund të ketë ndryshime, vetëm gjatë pushimeve verore. Të gjitha këto punkte shëndetësore, sipas tij, janë të pajisura me medikamente për raste emergjente.

Përveç kësaj, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përmendi edhe renovimin e mëhershëm që është bërë në QMF në Kijevë dhe Bellanicë, por shtoi gjithashtu se gjendja fizike e disa objekteve të tjera shëndetësore nuk është e kënaqshme, për çka sipas tij, është bërë kërkesë te Ministria e Shëndetësisë për intervenime si në objekte, ashtu edhe në disa rrethoja të tyre.

U mbajt mbledhja e tetëmbëdhjetë e KK të Malishevës

Miratohet buxheti komunal për vitet 2012-2014

Malishevë, 29 gusht

Kuvendi Komunal i Malishevës, ka mbajtur sot mbledhjen e tetëmbëdhjetë të radhës, të cilën e ka udhëhequr kryesuesi z.Ragip Begaj, ndërsa ka marrë pjesë edhe kryetari i komunës, z.Isni Kilaj.

Në këtë seancë është debatuar raporti i punës së kryetarit të komunës për gjashtëmujorin e parë të këtij viti dhe janë marrë disa vendime.

Kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, ka prezantuar punën për gjashtë muajt e parë të këtij viti, me ç'rast ka përmendur disa nga investimet kapitale të kryera nga qeveria komunale, përfshirë këtu përfundimin e ndërtimit të Qendrës së Kompetencës, Shtëpisë së Kulturës, pastaj projektet tjera si Palestra e Sporteve, fusha e futbollit, kolektori i ujërave të zeza, disa shkolla tjera, kanalizime, ujësjellës dhe investime tjera, disa prej të cilave kanë përfunduar e disa janë në vazhdim e sipër.

“Jam i sigurt se edhe ky vit do të jetë po aq i suksesshëm, si edhe vitet tjera”, ka thënë në fund kryetari i komunës, z.Isni Kilaj, pasi prezantoi para këshilltarëve komunal, punët e kryera, si dhe raportin financiar për gjashtë muajt e parë të këtij viti.

Më pas asambleja komunale, me shumicë votash ka miratuar kërkesën e kryetarit të komunës, për marrjen e vendimit për ndërtimin e parkut të gjelbër, buzë liqenit Mirusha, në Mirushë, një investim kapital, ku faza e parë e këtij projekti do të financohet nga Banka Botërore, përmes IOM-it, dhe kap një shumë prej rreth 100 mijë eurove.

Po ashtu në këtë mbledhje, me shumicë votash, është miratuar edhe projekt buxheti komunal për vitet 2012-2014, i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ndërsa i prezantuar para këshilltarëve komunal, nga kryetari i komunës, z.Isni Kilaj dhe drejtori i Drejtorisë për Buxhet e Financa, z.Vesel Krasniqi, të cilët edhe janë përgjigjur në pyetjet e këshilltarëve rreth këtij projekt buxheti.

